



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

**Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit,
Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit**

Vendosi: Trupi Gjykses II

Gjykatës Çarls L. Smith III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 20 dhjetor 2023

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim mbi Kërkesën e Përbashkët të Mbrojtjes për Zgjatjen e Afateve për t'iu
Përgjigjur Disa Parashtrimeve**

Prokurores së Specializuar
Kimberli P. Uest

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Gregori Kihou

Mbrojtësit të Viktimave
Sajmon Loz

Mbrojtjes së Kadri Veselit
Ben Emerson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit
Xhefri Roberts

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagendra

TRUPI GJYKUES II ("Trupi Gjykues"), në bazë të neneve 21(4)(c) dhe 40(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullës 9(5)(a) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL DHE PARASHTRIMET

1. Më 25 janar 2023, Trupi Gjykues lëshoi urdhrin mbi zhvillimin e gjykimit ("Urdhri mbi Zhvillimin e Gjykimit").¹
2. Më 16 nëntor 2023, Trupi Gjykues urdhëroi Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") të dorëzonte listën e dëshmitarëve që synon të thërrasë për të dëshmuar për periudhën e dëshmive nga janari deri në mars 2024, në përputhje me paragrafin 73 të Urdhrit mbi Zhvillimin e Gjykimit.²
3. Më 8 dhjetor 2023, ZPS-ja dorëzoi mocion për pranimin e provave të disa dëshmitarëve sipas rregullës 153 ("Kërkesa e Dytë sipas Rregullës 153").³
4. Më 14 dhjetor 2023, ZPS-ja dorëzoi mocion për pranimin e provave të disa dëshmitarëve sipas rregullës 154 ("Kërkesa e Dhjetë sipas Rregullës 154").⁴
5. Po atë ditë, ZPS-ja dorëzoi listën e dëshmitarëve për bllokun e dëshmive të periudhës 15 janar - 4 prill 2024 ("Lista e Dëshmitarëve të ZPS-së").⁵

¹ F01226/A01, Trupi Gjykues, *Shtojca 1 e Urdhrit mbi Zhvillimin e Gjykimit*, 25 janar 2023.

² Transkript i seancës, 16 nëntor 2023, faqja 10227, rreshtat 10-19.

³ F01994, Prokurorja e Specializuar, *Mocion i Prokurorisë për Pranimin e Provave të Dëshmitarëve W04016, W04019, W04044, W04305, W04361, W04722, W04816, W04850, W04851 dhe W04852 sipas Rregullës 153*, 8 dhjetor 2023, konfidencial, me Shtojcat 1-10, konfidenciale (versioni i redaktuar publik u dorëzua në të njëjtën ditë, F01994/RED).

⁴ F02005, Prokurorja e Specializuar, *Mocion i Prokurorisë për Pranimin e Provave të Dëshmitarëve W01453, W03878, W04446, W04575 dhe W04651 sipas Rregullës 154*, 14 dhjetor 2023, konfidencial, me Shtojcat 1-5, konfidenciale (versioni i redaktuar publik u dorëzua në të njëjtën ditë, F02005/RED).

⁵ F02007, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrim prej Prokurorisë i Listës së Dëshmitarëve për Periudhën 15 janar - 4 prill 2024*, 14 dhjetor 2023, me Shtojcat 1-2, konfidenciale.

6. Më 15 dhjetor 2023, ekipet e Mbrojtjes së Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit (bashkërisht "Mbrojtja") kërkuan zgjatjen e afateve për dorëzimin e përgjigjeve të përbashkëta ndaj Kërkesës së Dytë sipas Rregullës 153, Kërkesës së Dhjetë sipas Rregullës 154 dhe Listës së Dëshmitarëve të ZPS-së ("Parashtrimet e ZPS-së"), meqenëse afatet për përgjigjet përputheshin me periudhën e pushimit të gjykatës. Konkretisht, Mbrojtja kërkoi zgjatjen e afateve si vijon: (i) deri të hënën, 22 janar 2024, për përgjigjen ndaj Kërkesës së Dytë sipas Rregullës 153; (ii) deri të hënën, 15 janar 2024, për përgjigjen ndaj Kërkesës së Dhjetë sipas Rregullës 154; dhe (iii) deri të hënën, 15 janar 2025 për dorëzimin e kundërshtimeve ndaj Listës së Dëshmitarëve të ZPS-së, pa përfshirë parashtrimet në lidhje me W04489-ën dhe W04576-ën, të cilat do të përpiqet t'i dorëzojë brenda afatit aktual ("Kërkesa").⁶

7. Më 19 dhjetor 2023, ZPS-ja bëri të ditur se nuk kundërshton Kërkesën, në qoftë se Mbrojtja do të dorëzojë parashtrimet për W04489-ën dhe W04576-ën brenda afatit aktual.⁷

II. DISPOZITAT LIGJORE PÛRKATËSE

8. Sipas rregullës 9(5)(a), Trupi Gjykses mund të zgjasë, *proprio motu* ose nëse i tregohen arsye të vlefshme, afatet kohore të përcaktuara nga Rregullorja ose Trupi Gjykses.

III. DISKUTIM

9. Trupi Gjykses konstaton se Kërkesa është bërë në kohë pasi është parashtruar në kohë të mjaftueshme para përfundimit të afateve përkatëse.

10. Trupi Gjykses konstaton se Mbrojtja ka treguar arsye të vlefshme, siç përcaktohet në rregullën 9(5)(a), për zgjatjen e afateve për t'iu përgjigjur

⁶ CRSPD397, Mesazh Elektronik nga Mbrojtja drejtuar Njësisë së Administrimit të Gjykatës, 15 dhjetor 2023.

⁷ CRSPD399, Mesazh Elektronik nga ZPS-ja drejtuar Palëve dhe Pjesëmarrësve, 19 dhjetor 2023.

parashtrimeve të ZPS-së, duke pasur parasysh afatet e shumta me të cilat përballet Mbrojtja dhe pushimin e ardhshëm të Gjykatës. Trupi Gjykues vëren gjithashtu se ZPS-ja nuk kundërshton zgjatjen e kërkuar të afateve në qoftë se Mbrojtja do të dorëzojë parashtrimet e veta në lidhje me W04489-ën dhe W04576-ën brenda afatit aktual.

11. Megjithatë, Trupi Gjykues gjykon se zgjatjet e propozuara të afateve deri në 15 dhe 22 janar 2024 që kërkon Mbrojtja, nuk janë të arsyeshme në rrethanat ekzistuese. Veçanërisht, edhe pse Mbrojtja thekson se do t'i dorëzojë parashtrimet në lidhje me W04489-ën dhe W04576-ën para afateve të propozuara, zgjatjet e afateve që kërkon Mbrojtja nuk duket se janë të përligjura dhe mund të vonojnë procesin.

12. Duke marrë parasysh sa më sipër, përveçse në lidhje me W04489-ën dhe W04576-ën ku mbetet në fuqi afati i përcaktuar nga Rregullorja, Trupi Gjykues zgjat afatin e Mbrojtjes për t'iu përgjigjur Kërkesës së Dhjetë sipas Rregullës 154 dhe Listës së Dëshmitarëve të ZPS-së deri **të hënë, 8 janar 2024**, dhe afatin e Mbrojtjes për t'iu përgjigjur Kërkesës së Dytë sipas Rregullës 153 deri **të hënë, 15 janar 2024**.

IV. VENDIM

13. Duke marrë parasysh sa më sipër, Trupi Gjykues:

- a) **MIRATON** Kërkesën, pjesërisht; dhe
- b) **ZGJAT** afatin e Mbrojtjes për t'iu përgjigjur Kërkesës së Dhjetë sipas Rregullës 154 dhe Listës së Dëshmitarëve të ZPS-së **deri të hënën, 8 janar 2024** (përveçse në lidhje me W04489-ën dhe W04576-ën) dhe afatin e Mbrojtjes për t'iu përgjigjur Kërkesës së Dytë sipas Rregullës 153 **deri të hënën, 15 janar 2024**.

/nënshkrimi/

Gjykatës Çarls L. Smith, III

Kryegjykatës

E mërkurë, 20 dhjetor 2023

Në Hagë, Holandë.